



# Basic Facts



## Misioni

EULEX Kosova ka filluar në vitin 2008 si misioni civil më i madh në kuadër të Politikës së Përbashkët të Bashkimit Evropian për Siguri dhe Mbrotjtje. Misioni i përgjithshëm i EULEX-it është t'i asistojë autoriteteve të Kosovës në ngritjen e institucioneve të qëndrueshme dhe të pavarura të sundimit të ligjit.

Mandati aktual i Misionit ka filluar për të mbuluar periudhën deri më 14 qershor 2020 në bazë të Vendimit të Këshillit CFSP 2018/856. EULEX-i funksionon brenda kornizës së Rezolutës të Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244.

Misioni EULEX i mbështetë institucionet relevante të sundimit të ligjit në Kosovë në rrugën e tyre drejt rritjes së efektivitetit, qëndrueshmërisë, shumë-etnicitetit dhe llogaridhënies, të lira nga ndërhyrjet politike dhe në përputhje të plotë me praktikat më të mira të BE-së. Në kuadër të mandatit aktual, Misioni zhvillon aktivitete të monitorimit dhe ka funksione ekzekutive të kufizuara. Misioni vazhdon t'i mbështetë Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar në përputhje me legjislacionin përkatës të Kosovës.



**EULEX KOSOVO**  
Partnership for Justice

## Mandati

EULEX Kosova zbaton mandatin përmes Shtyllës për Monitorim dhe Shtyllës për Operacione.

Shtylla për Monitorim bënë monitorimin e rasteve dhe gjykimeve të caktuara në sistemin e drejtësisë të Kosovës. Ajo i përqendron aktivitetet e veta të monitorimit në raste të përzgjedhura të cilat janë trajtuar nga EULEX-i gjatë mandatit të tij të mëparshëm që ka përfunduar në mes të qershorit 2018 dhe që më pastaj i janë dorëzuar gjyqësorit vendas, si dhe në raste të tjera që mund të kenë ndikim mbi rrugëtimin evropian të Kosovës.

Shtylla për Monitorim po ashtu e mbështetë Shërbimin Korrektues të Kosovës për të zhvilluar ekip menaxherial të lartë të konsoliduar dhe profesionist si dhe kapacitete të qëndrueshme për të luftuar ndërhyrjet e papranueshme dhe trajtimet preferenciale të të burgosurve.

EULEX-i vazhdon të ofrojë mbështetje teknike për zbatimin e marrëveshjeve përkatëse nga Dialogu i fasilituar nga BE-ja për normalizimin e raporteve mes Beogradit dhe Prishtinës.

Funksionet operacionale kryhen nga Shtylla Operative e Misionit e cila ka kapacitet të mbetur të kufizuar si reagues i dytë në fushën e sigurisë dhe ofron mbështetje të vazhduar për kapacitetet e Policisë së Kosovës për kontrollin e turmave dhe të trazirave. Misioni vazhdon ta menaxhojë programin e tij për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe i ndihmon Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar me mbështetje logjistike dhe operacionale në pajtim me legjislacionin përkatës të Kosovës.

## Fakte të shpejta:

Mandati: deri më 14 qershor 2020

Ushtrues i detyrës së Shefit të Misionit: z. Bernd Thran

Kapaciteti i autorizuar: 503 staf

Zyrat qendrore: Prishtinë, Kosovë

Baza ligjore: Veprimi i Përbashkët i BE-së i muajit shkurt 2008 dhe Vendimet pasuese të Këshillit të qershorit 2010, 2012, 2014, 2016, 2018.

EULEX-i mbështetet nga të gjitha 28 Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian dhe nga pesë shtete kontribuuese (Kanadaja, Norvegjia, Zvicra, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara).



Press contacts and general information:  
[press@eulex-kosovo.eu](mailto:press@eulex-kosovo.eu) and [info@eulex-kosovo.eu](mailto:info@eulex-kosovo.eu)  
[www.eulex-kosovo.eu](http://www.eulex-kosovo.eu)

 [www.twitter.com/eulexkosovo](https://www.twitter.com/eulexkosovo)  
 [www.facebook.com/eulex.kosovo](https://www.facebook.com/eulex.kosovo)  
 [www.youtube.com/eulexkosovo](https://www.youtube.com/eulexkosovo)